



## **Fletënjoftim për parashtruese kërkese azili dhe parashtrues kërkese azili në lidhje me sëmundjen e Hepatitit B**

Në kuadër të ekzaminimeve shëndetsore tek Ju ndër të tjera është kryer edhe një ekzaminim mjeksor në lidhje me sëmundjen e Hepatitit B. Përgjat atijë ekzaminimi janë shprehur vlera të dukshme të gjakut, te cilin mund të jenë një sinjal për një infektim me sëmundjen e Hepatitit B. Konstatimet do të ju përcillen më tutje Entit kompetent te shëndetsisë dhe njëherit rezultati i ekzaminimit do të jë jipet në informacion organit i cili është kompetent për strehimin e Juaj njashtu edhe Entit Federal për Migracion dhe Refugjatë, siq edhe është e paraparë me ligjë (§ 62 Ligji i azilit).

Për të arritur dhe vertetur konstatimin, është patjetër e nevojshme të kryhen edhe ekzaminime tjera shtesë, siq është një ekzaminim i Mëlçisë me ultrazë dhe ekzaminime tjera të gjakut. Vetëm në ate mënyrë mund arrihet të vërtetohet fakti, se a keni nevojë të pranoni një trajtman mjeksor dhe nëse po, në cilat përmasa. Për këtë arsye ju lutemi të kontaktoni sa më shpejtë mjekun në qendrën e Juaj të strehimit. Ju njëherit keni mundësin të paraqiteni edhe në praksën e ndonjë mjeku tjetër te zgjidhur vullnetarisht nga ana e Juaj. Vërtetimin për kontrollë mjeksor ju mund ta mirrni tek Enti rajonal i Këshillit të vendit (Enti për çështje sociale) ose tek referati për çështje sociale në qytetin se ku edhe jetoni.

### Sëmundja e Hepatitit B:

Sëmundja e Hepatitit B është një sëmundje ngjitëse e Mëlçisë me një infektim viral. Ajo sëmundje mund te këtë rrjedhime të ndryshme. Si sipptome të mundshme të sëmundjes karakterizohen lëngime jokarakteristike të pjesës se epërme të barkut, anoreksia, mundime, të vjellat, lodhja ose animi në verdhëzim (sytë të verdhë, lëkura e verdhë dhe mukozë të verdhë). Por gjithashtu është edhe e mundshme të mos paraqiten fare lëngime të tilla. Ne gjithësetj 10 % të rasteve sëmundja e Hepatitit B nuk kurohet tërësisht dhe në ate ato raste sjellë edhe deri tek një ndezje kronike e Mëlçisë. Nëpërmjet asaj vjen deri tek shkatrimi suksesiv i Mëlçisë. Një e tillë mund të sjellë edhe deri tek një tkurrje mbresë (cerozë) e Mëlçisë dhe në disa prej rasteve edhe deri tek zhvillimi i një kaceri të Mëlçisë (karcinom hepatocelular).

### Rrugët e transmetimit të sëmundjes:

Transmetimi i sëmundjes me viret Hepatitit B bëhet prej njeriut në njeri, dhe në te shumten e rasteve nëpërmjet gjakut apo përgjat marrëdhënies seksuale, e në raste të rralla edhe nëpërmjet lëngjeve tjera të trupit.

*Marrëdhënia seksuale:* Eshtë një mundësi e shpeshtë e transmetimit të sëmundjes së Hepatitit B. Rreziku i transemtimit nëpërmjet marrëdhënies seksuale mund të reduktohet pothuajse në përgjithësi me përdorimin e kondomeve.

*Kontakti me gjakun i cili përmban viret e Hepatiti B:* Për shëpmbull përgjat kontaktit me lëndimet me derdhje gjaku, përdorimi i përbashkët i inxheksioneve (për shëmbull përgjat keqepërdorimit të substancave narkotike) gërrshërët e thonjëve, briskët e rrojës, aparaturat e rrojes ose brushat e dhëmbëve.

*Infektimi përgjat lindjes:* Një nënë e cila është e semurë nga sëmundja Hepatiti B shpeshëherë edhe infekton fëmijën e sajë përgjat lindjes me anë të kontaktit të gjakut.

*Tatuazhet, akupunktura dhe shpimi i vrimave të veshevë:* Përgjat një zbatimi jo të rregullt, johigjienik, është gjithashtu e mundshme të transmetohet sëmundja e Hepatitit B.

### Mundësit e trajtimit mjeksor:

Se sa është nevojshme të pranoni edhe Ju një trajtimit mjeksor në lidhje me sëmundjen e Hepatitit B, mvarret nga rezultatet e ekzaminimeve shtesë dhe njëherit do të ju sqarohet Juve më gjërësisht nga mjekja apo mjeku i Juaj.

### Rregullat e sjelljes për të mbrojtur njerëzit e tjerë ndaj një infektimi të mundshëm:

- Përgjat kontakteve normale sociale (si për shembull përshëndetja me dorë, bisedat)  nuk ekziston rrezik i infektimit me sëmundjen.
- Udhëzoni patjetër personat tjerë në lidhje me nevojën që ato të bartin dorëza për një përdorim përgjat një kontakti me gjakun e Juaj ose me lëngjet e trupit të Juaj (p.sh. përgjat dhënies së ndihmës së parë, veçanërisht përgjat trajtimit të plagëve).
- Informoni partnerët e Juaj intimë për mundësin e infektimit të Juaj me sëmundjen e Hepatitit B.
- Përdorni patjetër kondome përgjat marrëdhënieve të Juaja seksuale.
- Pjestarët e familjes së Juaj dhe pjestarët e amvisërisë duhet patjetër të marrin një vaksinim mbrojtës kundra sëmundjes së Hepatitit B.
- Ju nuk guxon të dhuroni gjak, nëse jeni të infektuar me sëmundjen e Hepatitit B!
- Tek gratë shtatëzëne të cilat kanë një infektim me Hepatit B është e mundshme që një vaksinim mbrojtës Hepatitit B për fëmijën i cili jipet menjëher pas lindjes të pengojë transmetimin e infektimit të fëmija.
- Informoni patjetër mjekun apo mjeken ordinues/e dhe mjekun apo mjeken ordinuese të dhëmbëve në lidhje me infektimin e Juaj me Hepatitit B.
- Në rastet e përkeqësimit të sëmundjes ju lutemi të kontaktoni patjetër Entin rajonal të Shëndetsisë dhe njoftoni ato në lidhje me infektimin e Juaj me sëmundjen e Hepatitit B.

Enti rajonal i shëndetsisë ju këshillon Ju me dëshirë.

### Informacione ndihmëse dhe fletëudhëzime ju mund ti gjeni gjithashtu edhe në faqet e internetit me sa vijon:

- Enti i Landit Bayern për Shëndetsi dhe Siguri tek gjërat ushqimore (Bayerisches Landesamt für Gesundheit und Lebensmittelsicherheit ose LGL) në faqen [www.lgl.bayern.de](http://www.lgl.bayern.de), këtu [http://www.lgl.bayern.de/gesundheitsinfektionsschutz/asylbewerber\\_gesundheit/index.htm](http://www.lgl.bayern.de/gesundheitsinfektionsschutz/asylbewerber_gesundheit/index.htm) (qëndron në dispozicion vetëm në gjuhën gjermane).
- Instituti Robert Koch [Robert Koch-Institut] në faqen [www.rki.de](http://www.rki.de) këtu <http://www.rki.de/asylsuchende> (qëndron në dispozicion vetëm në gjuhën gjermane).
- Qendra federale për këshillime shëndetsore (Bundeszentrale für gesundheitliche Aufklärung) në faqen <http://www.bzga.de> këtu <http://www.infodienst.bzga.de/?id=Seite3233> <http://www.infektionsschutz.de/erregersteckbriefe/> (qëndron në dispozicion në gjuhën gjermane, angleze, araba, turke, frënge dhe ruse).
- Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (Centers for Disease Control and Prevention ose CDC) në faqen <http://www.cdc.gov/vaccines/vpd-vac/hepb/default.htm> (në dispozicion vetëm në gjuhën angleze dhe spanjolle).
- Organizata botërore e Shëndetsisë (World Health Organization ose WHO) në faqen <http://www.euro.who.int/en/health-topics/communicable-diseases/hepatitis> (qëndron në dispozicion vetëm në gjuhën angleze).